




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78, paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. Nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PAGESËS SË NËPUNËSVE TEKNIK - MBËSHTETËS
TË ANGAZHUAR NË KUADËR TË DSHMS dhe QPS-SË

1. Lejohet pagesa e nëpunësve teknikë të mirëmbajtjes - pastrimit dhe roje të objekteve të DSHMS dhe QPS, sipas listës tabelare 5.
2. Pagesa do të bëhet nga linja buxhetore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vlerë prej : 1,935 €.
3. Mjetet financiare për pagesën e nëpunësve, do të barten në xhirollogaritë individuale të secilit nënpunës.
4. Pagesa bëhet për periudhën kohore : 01.01.2022 deri më : 31.07.2022 dhe 20.04.2022 deri më : 31.05.2022, sipas listës tabelare 5.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset : Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Me qëllim të mirëmbajtjes së higjienës në hapësirat e objekteve të DSHMS dhe QPS-së si dhe rojeve gjatë periudhës kohore sipas pikës 4 të dispozitivit të këtij vendimi, ishte nevojë e domosdoshme dhe obligative mbajtja e pastërtisë në këto ambiente, evitimin eventual të paraqitjes së qfardo epidemie e sidomos kur ende jemi në rrethana të pandemisë COVID-19.

Menaxhmenti i DSHMS dhe QPS-së gjatë kësaj periudhe kanë kërkuar që mos të ketë ndërprerje të shërbimeve të pastrimit dhe rojes edhe pse në kuptimin formalo juridik kemi pasur një shkëputje, pra Komunës së Gjiçanit, si autoritet kontraktues i ka skaduar kontrata për mirëmbajtjen - pastrimin me opertaorët ekonomik, por duke i marrë parasysh rrethanat të atëhershme, kemi lejuar angazhimin e këtyre nëpunësve në shërbim të institucioneve.

Ekzekutivi i Komunës së Gjiçanit, ka lidhur marrëveshje me Ndërmarrjen Publike Lokale "Tregu" në Gjiçan, ku pajtohen që t'i kryejnë obligimet e specifikuara në këtë marrëveshje të

mirëmbajtës dhe sigurimit fizik të objekteve publike komunale, specifikimet e shërbimeve, monitorimin e performancës së kryerjes së shërbimeve si dhe raportimin.

Nga data 01.08.2022 nëpunësit teknikë të pastrimit sipas procedurave të ndjekura nga përgjegjësit kompetent dhe në mbështetje të plotë me legjislacionin në fuqi, kalojnë në këtë ndërmarrje me kontrata të rregullta pune.

Duke u mbështetur në faktet e lartcekura, ekzekutivi i komunës merr për obligim dhe lejon pagesën e këtyre nëpunësve ashtu siç është cekur në dispozitivin e këtij vendimi sipas listës tabelare 5.

Vendimi i dorëzohet:

- Drejtorisë së DSHMS-së
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Komunës

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni



DSHMS-Gjilan

Lista e punëtorëve teknik-mirëmbajtës dhe roje në DSHMS dhe QPS të pa paguar për vitin 2022

Lista tabelare 5

Nr.	Emri	Mbledhëri	Institucioni	Pozita	Periudha e pa paguar	Kohëzgjatja	Paga neto	Paga bruto	Totali neto	Total brut
1	Mejreme	Rexhepi	QPS	Mirëmbajtës	20.04.2022-31.05.2022	1 muaj e 10 dit	249.18	270	332.24	360
2	Behlul	Zubaku	DSHMS-FSHL	Roje	01.01.2022-31.03.2022	3 muaj	231.2	262.5	693.6	787.5
2	Behlul	Zubaku	DSHMS-FSHL	Roje	01.05.2022-31.07.2022	3 muaj	231.2	262.5	693.6	787.5

Drejtoreshë në DSHMS

Aurion Osmani Buca



Punoi:

Zyrtare Financiare

Kosovare Gaspi

